



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Korniza Afatmesme (Buxhetore) e Shpenzimeve 2027 - 2029

Qershor 2026



Përmbajtje

HYRJE	3
Korniza e përgjithshme	3
Deklarata e qeverisë komunale për kornizën afatmesme të shpenzimeve 2027 - 2029.....	4
Orientimet Strategjike	5
KORNIZA FISKALE	6
PERSPEKTIVA E POLITIKAVE FISKALE	7
BUXHETI KOMUNAL PËR VITIN 2027 - 2029	8
Burimet e financimit komunal për vitin 2027 - 2029.....	9
Granti i përgjithshëm	10
Granti specifik për Arsim parauniversitar 2027	10
Granti specifik për Shëndetësi primare	11
Financimi për Teatro	11
Parashikimi i të hyrave vetanake komunale 2027 - 2029.....	11
Parashikimi i shpenzimeve buxhetore për periudhën 2027 - 2029.....	14
Zyra e Kryetarit.....	18
Zyra e Kuvendit Komunal	19
Drejtoria e Administratës dhe Personelit	20
Zyra e Prokurimit	21
Drejtoria e Inspeksionit.....	22
Drejtoria për Buxhet dhe Financa.....	23
Drejtoria e Shërbimeve Publike – Infrastruktura Rrugore.....	24
Drejtoria e Shërbimeve Publike - INFRASTRUKTURA PUBLIKE.....	25
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim + Zjarrfikëset.....	26
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	27
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	29
Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi	30
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	30
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	31
Shërbimet Sociale	32
Shërbimet Rezidenciale	32
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	33
Drejtoria për Arsim dhe Shkencë	34
PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP)	35
Vlerësimi i Kapaciteteve Investuese	35

HYRJE

Korniza e përgjithshme

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027 - 2029 si dokument i rëndësishëm dhe më kryesor paraqet koherencën, koordinimin dhe ndërlidhjen funksionale në mes të prioritetëve të përcaktuara me dokumentet strategjike komunale për zhvillim në njërin anë si dhe përfshirjen e tyre konkrete dhe specifike në projeksionet buxhetore për periudhën afatmesme. Duke u bazuar në këto premisa themelore që përfshijnë aspektet e menaxhimit të financave publike, ato fiskale, ekonomike dhe të barazisë shoqërore është konceptuar edhe Deklarata e Prioritetëve të Qeverisë komunale konform Strategjisë komunale për zhvillim. Prioritetet e Qeverisë Komunale të Gjakovës si pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve në nivel të Republikës së Kosovës: 2027 - 2029, janë të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, infrastrukturës komunale, sektorit të arsimit, kulturës, rinisë dhe sporteve, sektorit të shëndetësisë primare, atë të bujqësisë, mjedisit etj. Barazia gjinore njihet si prioritet ndër sektorial dhe do të mirret parasysh në secilin nga sektorët e lartpërmenduar. Prioritetet afatmesme 2027 - 2029, bazohen në Programin e Punës së Qeverisë Komunale dhe prioritetet e saj dhe Strategjinë e Zhvillimit Socio - Ekonomik Lokal për këtë periudhë. Strategjia për zhvillimin ekonomik lokal në komunën e Gjakovës është një dokument që thekson resurset dhe pasuritë e Komunës nga e cila dalin edhe projektet konkrete për realizim. Përgatitja e Strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal ka për qëllim që të shërbej si instrument për një planifikim të proceseve të zhvillimit lokal me gjithë përfshirje, për planifikimin e buxhetit komunal, për mobilizimin e mjeteve financiare, si dhe koordinimin e ndihmave në të dy nivelet, atë lokal dhe qendror. Gjithashtu, kjo do t'i mundësojë administratës komunale për formulimin e një Strategjie afatmesme dhe afatgjate lidhur me zhvillimin ekonomik lokal në territorin e Komunës në planin e ardhshëm 3 vjeçar.

Me Qarkoren e parë buxhetore nr.2027/01, të datës 15.05.2026 të lëshuar nga ana e MFPT, janë caktuar limitet e para buxhetore për Komuna për periudhën 3 vjeçare: 2027 - 2029 në mesin e të cilave edhe për Komunën e Gjakovës. Në procesin e realizimit të prioritetëve të Qeverisë komunale rëndësi e veçantë i kushtohet qëndrueshmërisë buxhetore dhe projeksioneve makro-fiskale për periudhën afatmesme. Në këtë drejtim do të punohet që të vazhdohet me ritmin e ngritjes së vazhdueshme të investimeve kapitale, pastaj të ruhet stabiliteti buxhetor, ngarkesë të ultë të biznesit me tatime si dhe rritja e nivelit të grumbullimit të hyrave vetanake. Komuna e Gjakovës do të inkurajojë, mbështesë, bashkërendojë dhe koordinojë me efikasitet politik, aktivitete e burime që i kontribuojnë prosperitetit e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të Komunës, fuqizimit të biznesit dhe sipërmarrjes, për një mirëqenie më të lartë njerëzore. Ky dokument është baza për përcaktimin e sektorëve me prioritet të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2027 - 2029. Ky plan i integruar nuk zëvendëson plane tjera por sigurohet që të gjithë plan programet dhe projektet tona të jenë të kanalizuar dhe të paraqesin koherencën dhe strategjinë e zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik të Komunës sonë në tre vitet e ardhshme. Objektivat e përcaktuara në KASH do të zhvillohen në aktivitete dhe projekte konkrete përmes procesit të rregullt buxhetor. Duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal si dhe Qëllimet e Zhvillimit të Mileniumit/Millennium Development Goals, Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2021 – 2025, Kornizën Afat Mesme të Shpenzimeve, si dhe Planet individuale Operacional të Departamenteve përkatëse, Komuna e Gjakovës arrin që të krijojë një kornizë e cila do të shpejtojë zhvillimin ekonomik duke siguruar një ambient të sigurtë dhe atraktiv edhe për investorët.

Deklarata e qeverisë komunale për kornizën afatmesme të shpenzimeve 2027 - 2029

Duke pasur të vendosur një bazë të mirë nga e cila niset zhvillimi i qëndrueshëm socio-ekonomik i Komunës tonë, prioritetet tona për tre vitet e ardhshme janë të fokusuara në katër shtyllat e mëposhtme:

- ❖ Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, krijimi i një ambienti të favorshëm për të operuar biznesi;
- ❖ Qeverisja e mirë dhe fuqizim i sundimit të ligjit, lirinë e shprehjes, autonominë dhe aksesin e barabartë në të mira publike dhe shërbime sociale për të gjithë komunitetet pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, mosha, orientimi seksual, origjina, kasta ose klasa, të ardhurat ose pasuria, gjuha, feja, bindjet, opinionet, shëndeti ose paaftësia.
- ❖ Zhvillimi i resurseve njerëzore, rritja e standardit jetësor, mirëqenies sociale për banorët e Komunës së Gjakovës.



Figure 1. Pozicioni gjeografik i Gjakovës dhe një motiv nga Lumi Krena

GJAKOVA – qytet i triumfit, i vlerave të mirëfillta, me një ekonomi të zhvilluar dhe konkuresive, një qytet i sigurt që promovon shëndetin, barazinë, arsimin cilësor, gjithëpërfshirjen, bujqësinë, kulturën, sportin dhe turizmin, ky është qyteti në të cilin ne duam të jetojmë, qytet që krijon një ambient të qëndrueshëm mjedisor për banorët e saj dhe jo vetëm.

Gjakova, vendi ynë do të triumfojë përmes rritjes së mirëqenies dhe përmirësimit të kushteve të jetesës së grave dhe burrave pa dallim përmes zhvillimit të NVM-ve, rritjes së investimeve kapitale nga buxheti komunal në lëmi të infrastrukturës, turizmit, bujqësisë, kulturës, sigurimit të cilësisë në arsim si dhe të shërbimeve shëndetësore dhe administrative.

Orientimet Strategjike

Promovimi dhe tërheqja e investimeve lokale dhe të huaja, fondeve të shtetit dhe agjensive të tjera në zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) dhe turizëm si kusht në rritjen e punësimit, mundësi e krijimit të vendeve të reja të punës, për të gjithë gratë, burrat e Komunës;

Zbutja e varfërisë përmes zhvillimit të bujqësisë; Ofrimin e mundësive të barabarta në qasjen në infrastrukturë, shkollim cilësor, jetesë të shëndoshë dhe të pastër dhe jetë kulturore dhe sportive të pasur për të gjithë gratë dhe burrat e Komunës së Gjakovës.

Objektivat e përgjithshme:

1. Të zhvillohet dhe të avancohet sektori NVM-ve dhe turizmit në Gjakovë;
2. Të zhvillohen dhe zgjerohen aktivitetet e sektorit të bujqësisë dhe Agro Industrisë në Gjakovë;
3. Avancimi i sistemit arsimor në të gjitha nivelet e shkollimit;
4. Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës si një kusht për zhvillim lokal, hartimi i hartës zonale, krijimi i një ambienti të qëndrueshëm mjedisor dhe ngritja e nivelit të siguri së përgjithshme;
5. Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies sociale dhe barazisë gjinore;
6. Përmirësimi dhe avancimi i shërbimeve administrative për qytetarët dhe menaxhimi i pasurisë komunale;
7. Ruajtja dhe kultivimi i traditës kulturore dhe asaj sportive në funksion të promovimit dhe zhvillimit të turizmit të Gjakovës.

Të gjitha prioritetet e lartpërmendura do të financohen duke ruajtur stabilitetin dhe qëndrueshmërinë makro-fiskale dhe duke vënë në pah barazinë shoqërore dhe prespektiven gjinore.

Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale konform KASH-it të lëshuar në nivel të Republikës së Kosovës – MFPT-se, gjatë muajit Maj 2026.

Korniza afatmesme buxhetore (KASH-i) komunal paraqet një mjet të procesit për zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KASH – Komunale do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioritetet të tanishme dhe afatmesme të Gjakovës si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2027 - 2029.

KORNIZA FISKALE

Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2027 - 2029 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Me lëshimin e Qarkoreve buxhetore nga MFPT-ja, për këtë periudhë mund të shfaqen edhe ndryshime të limiteve buxhetore, si dhe përcaktimin e shpenzimeve buxhetore sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve (Paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe investime kapitale).

Në këtë kornizë definohet qartë financimi komunal nga grantet qeveritare për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitin 2028 dhe 2029 përfshirë të hyrat vetanake komunale, si pjesë integrale e KASH-it : 2027 - 2029.

Nga aspekti i kornizës së re ligjore, sistemi i financimit komunal ka pësuar reforma progresive përkatësisht ndryshime të mëdha në vijën horizontale dhe vertikale të financimit. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2027 , si dhe pjesëmarrja e buxhetit komunal në Buxhetin e Republikës së Kosovës, janë strukturuar në linjë me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL).

Përcaktimi i shumave agregate të granteve qeveritare dhe alokimi i tyre në komunat individuale në periudhën afatmesme të bazuar nga propozim-grantet specifike nga ministritë e linjës MASHT, MSH, MAPL dhe MPMS, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar KASH-in për periudhën 2027 – 2029.

- ❖ Respektimi dhe zbatimi i parimeve të përgjithshme të përcaktuara në LFPL
- ❖ Formulat shtetërore për arsimin para universitar dhe shëndetësinë primare, për alokimin e granteve specifike në arsim dhe shëndetësi
- ❖ Korniza makro-fiskale si bazë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, në kuadër të prioritetëve qeveritare.

Komunat, nga viti në vit kanë pasur një shkallë të rritur të decentralizimit fiskal dhe transparencës. Sistemi aktual i financave komunale përbën decentralizimin fiskal të avancuar, komunat kanë kompetenca të konsiderueshme për shpenzimet, kompetenca për ofrim të shërbimeve publike, autorizime për mbledhjen e të hyrave, dhe autoritet të gjerë në menaxhimin e financave publike.

Përkushtimi i përgjithshëm për të përmirësuar elementet kyçe të procesit të zhvillimit të buxhetit, ka kërkuar edhe disa ndryshime në formatin e prezantimit të buxhetit komunal. Prandaj, jemi mbështetur në aspektet kryesore të mëposhtme të procesit buxhetor:

- ❖ Shfrytëzimi i buxhetimit në nivel të programit dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të evidencës kontabël;
- ❖ Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe

- ❖ Zbatimi i konceptit mbi planifikimin shumëvjeçar të buxhetit/kapitaleve dhe prezantimi i të gjithë zërave të buxhetit për vitin paraprak, vitin e tanishëm buxhetor dhe për dy vitet pasuese.

Futja në përdorim e buxhetimit kapital shumëvjeçar, përfshirë këtu integrimin e informatave për rezultatet e planifikuara në sistemin e PIP-it. Gjatë këtij viti komunat do të hartojnë për secilin program strategjinë me synimet dhe objektivat, përfundimet dhe rezultatet që synohen të arrihen përmes procesit buxhetor.

PERSPEKTIVA E POLITIKAVE FISKALE

Sipas KASH-it të Republikës së Kosovës dhe Qarkores së parë buxhetore nr.2027/01 për Komuna të dt. 15.05.2026 dhe në bazë të shënimeve statistikore të regjistrimit të fundit të popullsisë së Kosovës të vitit 2024, rrjedhë se Komuna e Gjakovës ka 78,699 banorë, dhe nga Komisioni i Granteve – MFPT për vitin 2027 Komunës sonë iu është ndarë buxhet fillestar në shumë prej 43,715.898.00€, nga te cilat Grant Qeveritar 36,348,936.00 € (83.15%), te hyra vetanake 6,756,962.00 (15.46%), buxhet ekstra për shërbime rezidenciale 610,000.00 € (1.39%) i cili buxhet përbën shumën prej 43,715,898.00€, apo për 1,322,654.00€ në total më i lartë se për vitin aktual 2026.

Tabela nr. 1. Krahasimi i Buxhetit 2026/2027

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1.	Buxheti komunal 2026 (aktual)	42,393,244.00
2.	Buxheti i planifikuar 2027	43,715,898.00
	Ndryshimi	+1.322.654.00

Burimi: Qarkorja Buxhetore 2027/01, MFPT 2026


BUXHETI KOMUNAL PËR VITIN 2027 - 2029

Bazuar në tabelat e buxhetit komunal nga vitet e kaluara dhe me qëllim të vazhimit të reformave të procesit buxhetor, buxheti komunal për vitin 2027 do të planifikohet dhe pasqyrohet sipas strukturës bazë të programeve dhe nën-programeve buxhetore. Për të përmirësuar gjithë-përfshirjen, transparencën dhe kredibilitetin e formulimit të buxhetit komunal, synohet që hartimi i buxhetit të ndërtohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Prioritet për financim kanë projektet që janë të vazhdueshme që kanë filluar në vitet e mëparshme dhe atyre që janë në harmoni me prioritetet e Komunës.

STRUKTURA E BUXHETIT PËR VITIN 2027

Struktura e Buxhetit Komunal sipas vlerësimeve të para për vitin 2027 duket si vijon:

Paga dhe mëditje	23,500,000.00	53.76%
Mallra dhe shërbime	4,700,000.00	10.75%
Shpenzime komunale	1,140,400.00	2.61%
Subvencione	1,600,053.00	3.66%
Investime kapitale	12,775,445.00	29.22%
TOTALI	43,715,898.00	100.00%



Burimet e financimit komunal për vitin 2027 - 2029


Financimi komunal përfshinë: grantet specifike operative për arsim para universitar dhe shëndetësi primare, grantet për kompetencat e shtuara, të hyrat vetanake të komunave, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga jashtë. Ndërsa aspekti i huamarrjes së komunave do të jetë si opsion i mundshëm i financimit që është paraparë në ligjin përkatës dhe në kuadër të rregullës fiskale të përcaktuar në LMFP të dakorduar me Misionin e FMN-së.

Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të Komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL. Sipas Qarkores së parë nr.2027/01, të dt. 15.05.2026 të lëshuar nga ana e MFPT-ve për periudhën 2027 - 2029 për Komunën e Gjakovës është caktuar për financimin e shpenzimeve 3 vjeçare si në tabelën 2.

Tabela nr.2. Totali i Burimeve të financimit komunal për vitet: 2027 – 2029

Kategoritë BUXHETORE - Burimet e financimit		2026	2027	2028	2029
		Aktual	Vlerësuar	Vlerësuar	Vlerësuar
1	Granti i Përgjithshëm	16,347,820.00	19,378,008.00	19,254,462.00	20,774,708.00
2	Granti specifik i Arsimit	13,516,159.00	12,500,689.00	12,875,709.00	13,261,981.00
3	Granti specifik i Shëndetësisë	4,775,264.00	4,128,242.00	4,252,090.00	4,379,652.00
	Financimi për shërbimet rezidenciale (SHKPM)	150,000.00	150,000.00	200,000.00	200,000.00
	Financimi për shërbimet rezidenciale (SHKPAK)	230,000.00	230,000.00	200,000.00	200,000.00
	Financimi për shërbimet rezidenciale (SHEMF)	230,000.00	230,000.00	210,000.00	210,000.00
4	Të hyrat vetanake komunale	6,820,123.00	6,756,962.00	6,950,112.00	7,252,287.00
5	Financimi për teatro	323,878.00	341,997.00	360,806.00	380,651.00
TOTALI:		42,393,244.00	43,715,898.00	44,303,179.00	46,659,279.00

Grafiku i trendit të buxhetit komunal 2027-2029



Qarkorja Buxhetore 2027/01, MFPT 2026

Burimi:

Granti i përgjithshëm

Komunat do të pranojnë Grantin e përgjithshëm, i cili është grant i sistemit të mbyllur dhe do ta shfrytëzojnë për ushtrimin e kompetencave të caktuara komunale në përputhje me kuadrin ligjor. Granti i Përgjithshëm mundëson një shkallë të arsyeshme të qëndrueshmërisë në të hyrat komunale, gjithashtu është mjet adekuat për vendosjen e barazive ndërmjet komunave dhe mundëson alokimin adekuat të burimeve për komunitet pakicë në komunat përkatëse.

Shuma e Grantit të përgjithshëm është dhjetë për qind (10%) e të hyrave totale buxhetore të Qeverisë qendrore, duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja.

Me qëllim të nivelimit të kapacitetit të ulët të hyrave vetanake të komunave më të vogla, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse (paushalle) prej 140,000.00 €, minus 1 € për kokë banori ose 0 € për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë.

Indikatorët që janë përdorur për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna janë:

- ❖ Numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë për qind (89%); përmasat gjeografike të Komunës me gjashtë për qind (6%); numri i popullsisë pakicë në komunë (3%); komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy për qind (2%).
- ❖ Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim para universitar, për Shëndetësi primare si dhe financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS financohen nga Granti i përgjithshëm në komuna.

Sipas Qarkores së parë buxhetore nr.2027/01 për Komuna, të lëshuar nga ana e MFPT, me datë 15 Maj 2026, Granti i përgjithshëm për Komunën e Gjakovës, për vitin 2027 është paraparë në shumë prej 19,378,008.00 €.

Granti specifik për Arsim parauniversitar 2027

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASH për vitin 2027-2029.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kriteret:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2025/2026;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;

- h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
- i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
- j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
- k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
- l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
- m) Koordinatorët e cilësisë;
- n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
- o) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;

Sipas Qarkores së parë buxhetore nr.2027/01, për Komuna, të lëshuar nga ana e MFPT-ve, me datë 15 Maj 2026, për Arsimin para universitar të Komunës së Gjakovës, për vitin 2027 është paraparë Granti në shumë prej 12,500,689.00 €.

Granti specifik për Shëndetësi primare

Granti specifik për Shëndetësi bazohet në sistem të hapur në përputhje me LFPL.

Grantin specifik për shëndetësi primare për vitin 2027 është aprovuar në shumë prej 85.86 milion euro.

Sipas Qarkores së parë buxhetore nr. 2027/01 të lëshuar nga ana e MFPT-ve, me datë 15 Maj 2026, për Shëndetësinë primare të Komunës së Gjakovës, për vitin 2027 është paraparë Granti në shumë prej 4,128,242.00 €.

Financimi për Teatro

Financimi për teatro për vitin 2027 është aprovuar përsëri për Komunën e Gjakovës dhe komunat tjera nga Komisioni i Granteve.

Në total janë të parapara 341,997.00 € prej të cilave 291,944.00€ të destinuara për paga dhe 50,053.00 € për subvencione.

Parashikimi i të hyrave vetanake komunale 2027 - 2029

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2027 bazuar, në vlerësimet makrofiskale, janë aprovuar në shumë prej 132.2 milion euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale.

Projeksionet e të hyrave vetanake për secilën komunë janë bazuar në rekomandimet e komisionit të granteve, të përfshirë në raportin e Vlerësimit të Përshtatshmërisë së Financimit të Komunave.

Në këtë projeksion janë marrë parasysh të hyrat nga tatimi në pronat e paluajtshme sipas faturimit të tatimit në pronë (ngarkesat tatimore në pronë dhe tokë) dhe mesatarja e tri viteve të fundit e të hyrave jo tatimore, duke përfshirë të hyrat nga gjocat e gjykatave dhe gjocat në trafik të hyra këto të cilat planifikohen nga niveli qendror.

Me Qarkoren buxhetore nr. 2027/01, për komunën e Gjakovës, për vitet: 2027 – 2029 është përcaktuar Planin i të hyrave vetanake si vijon:

- ❖ Viti 2027 6,756,962.00 €,
- ❖ Viti 2028 6,950,112.00 €,
- ❖ Viti 2029 7,252,287.00 €.

Komuna e Gjakovës ka propozuar që të hyrat vetanake të jenë për vitet 2027 - 2029 si në tabelën nr.3.

Kodet	BURIMI I TË ARDHURAVE	2027 Planifikimi	2028 Planifikimi	2029 Planifikim
1	Administrata e përgjithshme	116,317	122,110	132,282
50013	Certifikatat e lindjes	71,580	75,144	81,404
50014	Certifikatat e kurorëzimit	14,316	15,029	16,281
50015	Certifikatat e vdekjes	4,295	4,509	4,884
50016	Certifikatat e tjera	3,693	3,877	4,199
50017	Taksa të verifikimit të dokumenteve të ndryshme	22,434	23,551	25,513
	Taksa administrative te ndryshme	-	-	-
2	Drejtoria e Inspeksionit	92,338	96,936	105,011
50505	Inspektimi veterinar brenda vendit	-	-	-
50507	Leje për plotësimin e kushteve sanitare teknike	54,759	57,486	62,274
50104	Gjobat nga inspektoriati	37,579	39,451	42,737
50019	Taksa administrative pijeve alkoolike	-	-	-
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3,780,970	3,825,915	3,867,846
50408	Qiraja për lokalet e komunës	89,475	93,931	101,755
40110	Tatimi mbi pronën dhe tokë	3,503,598	3,534,730	3,552,405
50001	Taksa për regjistrimin e automjeteve	187,897	197,254	213,686
4	Drejtoria e Shërbimeve Publike	130,275	136,763	148,155
50103	Sekuestrimi i automjeteve	-	-	-
50008	Të hyrat nga parkingjet	80,527	84,538	91,580
50005	Taksa për leje vozitje - autobusëve	20,132	21,134	22,895
50406	Të hyrat nga tregjet	20,579	21,604	23,404
50401	Shitja e makinave	-	-	-
50109	te hyrat nga kompenzimi i demve te aseteve rrugore	9,037	9,487	10,277
5	Drejtoria e Agrikulturës	60,843	63,873	69,193
50012	Shndërrimi i tokës bujqësore ne jo - bujqësore	60,843	63,873	69,193
	Shitja e drunjtëve te konfiskuar	-	-	-
6	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	232,187	243,750	264,054
50029	Leje - Taksa mbi firmën e biznesit	223,687	234,827	254,388
50019	Leje - Taksa për zgjatjen e orarit te punës	8,500	8,923	9,667
7	Kadastra	224,344	235,516	255,134

50504	Të hyrat nga shërbimet kadastrale	224,344	235,516	255,134
50503	Të hyrat nga Ekspertiza	-	-	-
8	Drejtoria e Urbanizmit	1,608,562	1,688,669	1,829,335
50009	Lejet e ndërtimit - (Taksa administrative dhe Tarifa rregullative për rritjen e densitetit)	1,452,876	1,525,229	1,652,281
50011	Taksat komunale: Pëlqimet e ndryshme, ndarjet fizike, ekstraktet nga planet, lejet dhe pëlqimet për objektet e infrastrukturës dhe taksa nga leja mjedisore)	37,579	39,451	42,737
50405	Kompensimi për shfrytëzimin e hapësirës publike: (Kompensimi për objektet montuese- de montuese, për panot reklamuese dhe për hapësirat publike)	42,053	44,147	47,825
50408	Qiraja: (Qiraja për shfrytëzimin e banesave nga programi i banimit social)	31,316	32,876	35,614
50026	Taksat komunale nga trajtimi i ndërtimeve pa Leje – legalizimi i objekteve	44,737	46,965	50,878
9	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	22,327	23,439	25,391
	Të hyrat nga kultura, rinia dhe sportet	22,327	23,439	25,391
	Dënimet në trafik-direkt nga MF-i	-	-	-
	Te hyrat nga Gjykata	-	-	-
	Të hyrat nga Pyjet	-	-	-
I.	TOTALI I ADMINISTRATES KOMUNALE	6,268,162	6,436,970	6,696,401
II.	ARSIMI	378,197	397,032	430,104
III.	SHENDETËSIA	110,602	116,110	125,782
	SUB TOTALI I + II + III	6,756,962	6,950,112	7,252,288
IV.	Participimet e qytetarëve dhe të hyrat tjera etj.			
	SUB TOTALI I + II + III+IV+V	6,756,962	6,950,112	7,252,288

Tabela nr.3 – Vlerësimet preliminare për të hyrat vetanake të Komunës së Gjakovës 2027 - 2029.

Parashikimi i shpenzimeve buxhetore për periudhën 2027 - 2029

Për të pasur një pasqyrë mbi shpenzimet buxhetore të Komunës së Gjakovës sipas kategorive ekonomike buxhetore, në tabelën vijuese të këtij KAB-i, po paraqesim trendët historike të shpenzimeve për periudhën e dy viteve të kaluara: 2024, 2025, dhe buxhetin aktual 2026, me ç'rast mund të shihen shumat e mjeteve të shpenzuara buxhetore sipas destinimeve dhe pozicioneve buxhetore.

Tabela 4. Trendet historike të financimit sipas strukturës ekonomike për Komunën e Gjakovës 2024-2026.

	Komuna e Gjakovës	2024 (Shpenzuar)	2025 (Shpenzuar)	2026 (Aktual)
1	Paga dhe mëditje	20,237,270.56	20,786,943.02	21,817,301.00
2	Mallra dhe shërbime	4,836,557.52	4,707,709.59	4,360,000.00
3	Shpenzime komunale	784,056.60	947,784.05	1,010,000.00
4	Subvencione dhe transfere	1,010,565.29	1,001,808.10	1,602,000.00
5	Shpenzime kapitale	14,767,030.86	14,614,519.66	13,603,943.00
	Totali :	41,635,480.83	42,058,764.42	42,393,244.00
	Numri i stafit	2252	2285	2305

Propozimi i financimit të Komunës së Gjakovës sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve për periudhën: 2027 - 2029 është si në tabelën 5.

Tabela 5. Kufijtë e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike të vlerësuara për Financim për komunën e Gjakovës: 2027 - 2029

	Komuna e Gjakovës	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	23,500,000.00	23,700,000.00	24,200,000.00
2	Mallra dhe shërbime	4,700,000.00	4,900,000.00	5,100,000.00
3	Shpenzime komunale	1,140,400.00	1,200,000.00	1,300,000.00
4	Subvencione dhe transfere	1,600,053.00	1,703,053.00	1,900,000.00
5	Shpenzime kapitale	12,775,445.00	12,803,126.00	14,159,279.00
	Totali :	43,715,898.00	44,306,179.00	46,659,279.00
	Numri i stafit	2305	2305	2305

SQARIM - Shpërndarja e Buxhetit komunal për periudhën: 2027 - 2029, siç shihet edhe në tabelën e lartshënuar, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, është bërë konform limiteve buxhetore të përcaktuara me Qarkoren e parë buxhetore 2027/01, të dt.15.05.2026 të lëshuar nga ana e MFPT-ja.

Tabela 6. Kufiitë buxhetor sipas drejtorive për vitin 2027

Kodi	Programet	r. Pur	2027 Paga dhe Meditje	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfer	Shpenzime Kapitale	TOTAL
160/16016	Zyra e Kryetarit	41	459,854.00	140,000.00		170,000.00		769,854.00
163/16316	Aministrata dhe Person	31	312,303.00	600,000.00	80,000.00			992,303.00
166/16631	Inspektimet	23	280,869.00	130,000.00				410,869.00
167/16780	Prokurimi	7	77,000.00	10,000.00				87,000.00
169/16916	Zyra e Kuvendit Komun	39	454,970.00	30,000.00				484,970.00
175/17516	Buxhet dhe Financa	28	299,500.00	50,682.00			1,297,166.00	1,647,348.00
180/18176	Infrastruktura Publike	8	79,000.00	1,200,000.00	390,000.00	10,000.00	950,000.00	2,629,000.00
180/18016	Infrastrukture Rrugore	7	85,000.00	200,000.00			7,100,000.00	7,385,000.00
180/18420	Zjarrfikësat dhe Inspek	55	761,476.00	100,000.00	20,000.00		250,000.00	1,131,476.00
195/19580	Zyra Komunale për Kor	4	37,000.00	27,000.00		40,000.00		104,000.00
470/47016	Bujqësi, Pylltari dhe Zh	6	78,000.00	20,000.00	2,000.00	190,000.00	450,000.00	740,000.00
480/48016	Zhvillimi Ekonomik	12	123,000.00	50,000.00		160,000.00	200,000.00	533,000.00
650/65080	Shërbimet Kadastrale	19	203,000.00	20,000.00	15,000.00		500,000.00	738,000.00
660/66385	Planifikimi Urban dhe I	18	190,000.00	100,000.00			100,000.00	390,000.00
730	Shëndetësia dhe Mirëq	361	4,308,467.00	833,000.00	110,400.00	150,000.00	-	5,401,867.00
73025	Administrata	7	87,000.00	10,000.00				97,000.00
73950	Shërbimet e Shëndetës	354	4,221,467.00	823,000.00	110,400.00	150,000.00		5,304,867.00
755/75576	Shërbimet Sociale	18	197,568.00	30,000.00	8,000.00	20,000.00		255,568.00
755/75577	Shërbimet Rezidenciale	5	55,503.00	45,000.00	5,000.00		514,279.00	619,782.00
850	Kultura, Rinia dhe Sporte	56	614,655.00	162,000.00	90,000.00	290,053.00	850,000.00	2,006,708.00
85016	Shërbimet Kulturore	31	291,211.00	125,000.00	85,000.00	220,000.00	650,000.00	1,371,211.00
85056	Përkrahja e rinisë	3	31,500.00	10,000.00		20,000.00	200,000.00	261,500.00
85175	Teatri	22	291,944.00	27,000.00	5,000.00	50,053.00		373,997.00
920	Arsimi dhe Shkenca	1567	14,882,835.00	952,318.00	420,000.00	570,000.00	564,000.00	17,389,153.00
92080	Administrata	11	120,000.00	220,000.00	150,000.00	570,000.00	564,000.00	1,624,000.00
92510	Arsimi parashkollor	120	1,150,000.00	227,790.00	80,000.00			1,457,790.00
93450	Arsimi fillor	1116	10,400,835.00	265,000.00	90,000.00			10,755,835.00
94650	Arsimi i mesëm	320	3,212,000.00	239,528.00	100,000.00			3,551,528.00
TOTAL KËRKESAT		2305	23,500,000.00	4,700,000.00	1,140,400.00	1,600,053.00	12,775,445.00	43,715,898.00

Tabela 6. Kufijtë buxhetor sipas drejtorive për vitin 2028

Kodi	Programet	Nr. Pun.	2028 Paga dhe shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfer	Shpenzime Kapitale	TOTAL
160/16016	Zyra e Kryetarit	41	459,854.00	140,000.00		183,000.00		782,854.00
163/16316	Aministrata dhe Pers	31	312,303.00	600,000.00	80,000.00			992,303.00
166/16631	Inspektimet	23	280,869.00	130,000.00				410,869.00
167/16780	Prokurimi	7	77,000.00	10,000.00				87,000.00
169/16916	Zyra e Kuvendit Kom	39	454,970.00	30,000.00				484,970.00
175/17516	Buxhet dhe Financa	28	299,500.00	50,682.00			3,273,126.00	3,623,308.00
180/18016	Shërbimet Publike - I	8	79,000.00	1,300,000.00	430,000.00	10,000.00	1,250,000.00	3,069,000.00
180/18016	Infrastruktura Rrugor	7	85,000.00	200,000.00			3,850,000.00	4,135,000.00
180/18420	Zjarrfikësat dhe Inspe	55	761,476.00	110,000.00	20,000.00		300,000.00	1,191,476.00
195/19580	Zyra Komunale për K	4	37,000.00	27,000.00		40,000.00		104,000.00
470/47016	Bujqësi, Pylltari dhe Z	6	78,000.00	20,000.00	2,000.00	200,000.00	550,000.00	850,000.00
480/48016	Zhvillimi Ekonomik	12	123,000.00	50,000.00		180,000.00	400,000.00	753,000.00
650/65080	Shërbimet Kadastrale	19	203,000.00	23,000.00	15,000.00		600,000.00	841,000.00
660/66385	Planifikimi Urban dhe	18	190,000.00	110,000.00			100,000.00	400,000.00
730	Shëndetësia dhe Mirëq	361	4,408,467.00	860,000.00	130,000.00	190,000.00	-	5,588,467.00
73025	Administrata	7	87,000.00	10,000.00				97,000.00
73950	Shërbimet e Shëndet	354	4,321,467.00	850,000.00	130,000.00	190,000.00		5,491,467.00
755/75576	Shërbimet Sociale	18	197,568.00	30,000.00	8,000.00	20,000.00		255,568.00
755/75577	Shërbimet Rezidencia	5	55,503.00	45,000.00	5,000.00		610,000.00	715,503.00
850	Kultura, Rinia dhe Spor	56	614,655.00	162,000.00	90,000.00	280,053.00	520,000.00	1,666,708.00
85016	Shërbimet Kulturore	31	291,211.00	125,000.00	85,000.00	210,000.00	320,000.00	1,031,211.00
85056	Përkrahja e rinisë	3	31,500.00	10,000.00		20,000.00	200,000.00	261,500.00
85175	Teatri	22	291,944.00	27,000.00	5,000.00	50,053.00		373,997.00
920	Arsimi dhe Shkenca	1567	14,982,835.00	1,002,318.00	420,000.00	600,000.00	1,350,000.00	18,355,153.00
92080	Administrata	11	120,000.00	270,000.00	150,000.00	600,000.00	1,350,000.00	2,490,000.00
92510	Arsimi parashkollor	120	1,150,000.00	227,790.00	80,000.00			1,457,790.00
93450	Arsimi fillor	1116	10,500,835.00	265,000.00	90,000.00			10,855,835.00
94650	Arsimi i mesëm	320	3,212,000.00	239,528.00	100,000.00			3,551,528.00
TOTAL		2,305	23,700,000.00	4,900,000.00	1,200,000.00	1,703,053.00	12,803,126.00	44,306,179.00

Tabela 6. Kufijtë buxhetor sipas drejtorive për vitin 2029

Kodi	Programet	Nr. Pun.	2029 Paga dhe shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfer	Shpenzime Kapitale	TOTAL
160/16016	Zyra e Kryetarit	41	459,854.00	140,000.00		200,000.00		799,854.00
163/16316	Aministrata dhe Perso	31	312,303.00	600,000.00	80,000.00			992,303.00
166/16631	Inspektimet	23	280,869.00	130,000.00				410,869.00
167/16780	Prokurimi	7	77,000.00	10,000.00				87,000.00
169/16916	Zyra e Kuvendit Kom	39	454,970.00	30,000.00				484,970.00
175/17516	Buxhet dhe Financa	28	299,500.00	50,682.00			7,089,279.00	7,439,461.00
180/18016	Shërbimet Publike - I	8	79,000.00	1,300,000.00	500,000.00	10,000.00	950,000.00	2,839,000.00
180/18016	Infrastruktura Rrugor	7	85,000.00	200,000.00			2,600,000.00	2,885,000.00
180/18420	Zjarrfikësat dhe Inspe	55	761,476.00	110,000.00	20,000.00		250,000.00	1,141,476.00
195/19580	Zyra Komunale për K	4	37,000.00	27,000.00		40,000.00		104,000.00
470/47016	Bujqësi, Pylltari dhe Z	6	78,000.00	20,000.00	2,000.00	250,000.00	600,000.00	950,000.00
480/48016	Zhvillimi Ekonomik	12	123,000.00	50,000.00		200,000.00	400,000.00	773,000.00
650/65080	Shërbimet Kadastrale	19	203,000.00	23,000.00	15,000.00		700,000.00	941,000.00
660/66385	Planifikimi Urban dhe	18	190,000.00	110,000.00				300,000.00
730	Shëndetësia dhe Mirëq	361	4,658,467.00	960,000.00	130,000.00	263,000.00	-	6,011,467.00
73025	Administrata	7	87,000.00	10,000.00				97,000.00
73950	Shërbimet e Shëndet	354	4,571,467.00	950,000.00	130,000.00	263,000.00		5,914,467.00
755/75576	Shërbimet Sociale	18	197,568.00	30,000.00	8,000.00	20,000.00		255,568.00
755/75577	Shërbimet Rezidencia	5	55,503.00	45,000.00	5,000.00		610,000.00	715,503.00
850	Kultura, Rinia dhe Spor	56	614,655.00	162,000.00	90,000.00	280,053.00	-	1,146,708.00
85016	Shërbimet Kulturore	31	291,211.00	125,000.00	85,000.00	210,000.00		711,211.00
85056	Përkrahja e rinisë	3	31,500.00	10,000.00		20,000.00		61,500.00
85175	Teatri	22	291,944.00	27,000.00	5,000.00	50,053.00		373,997.00
920	Arsimi dhe Shkenca	1567	15,232,835.00	1,102,318.00	450,000.00	636,947.00	960,000.00	18,382,100.00
92080	Administrata	11	120,000.00	300,000.00	180,000.00	636,947.00	960,000.00	2,196,947.00
92510	Arsimi parashkollor	120	1,150,000.00	257,790.00	80,000.00			1,487,790.00
93450	Arsimi fillor	1116	10,750,835.00	305,000.00	90,000.00			11,145,835.00
94650	Arsimi i mesëm	320	3,212,000.00	239,528.00	100,000.00			3,551,528.00
TOTAL		2305	24,200,000.00	5,100,000.00	1,300,000.00	1,900,000.00	14,159,279.00	46,659,279.00

Zyra e Kryetarit

Deklarata e vizionit:

Një Komunë shembull për Komunitet tjerë me mundësi zhvillimi me të drejta të barabarta për të gjithë gratë dhe burrat e Komunës dhe trajtimi i prioriteteve në të gjitha fushat e zhvillimit si Komunë.

Deklarata e misionit:

Krijimi i rregulloreve të reja në harmoni me ligjet e aplikueshme, zbatimi i të gjitha dispozitave ligjore dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me qeverisjen komunale, zhvillimin ekonomik, barazisë gjinore, ngritjen e transparencës, llogaridhënies, efikasitetit të shërbimeve dhe rritjen e mirëqenies së banorëve të Komunës së Gjakovës

Deklarata e Qëllimit:

Zhvillimin e përgjithshëm të Komunës së Gjakovës, hapja e vendeve të reja të punës, përmirësimi i klimës së biznesit përmes inovacionit dhe subvencionimit të ndërmarrësve të rinj, arritja e nivelit më të lartë të standardit të jetës së banorëve të Komunës sonë, ngritje e nivelit të përgjithshëm të arsimit, barazisë gjinore, përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, tejkalimi i problemeve për kushtet bazike të jetës dhe përmbushja e ndryshimit të qëndrueshëm të Komunës së Gjakovës sonë. Përveq kësaj synojmë ta përvetësojmë nivelin e performancës dhe lidhur me këtë të përfitojmë fonde shtesë nga donatorët.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 – 2029.

	ZYRA E KRYETARIT	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	478,218.00	459,854.00	459,854.00	459,854.00
2.	Mallra dhe shërbime	140,000.00	140,000.00	140,000.00	140,000.00
3.	Subvencione	220,000.00	170,000.00	183,000.00	200,000.00
4.	Shpenzime Kapitale				
	TOTALI	838,218.08	769,854.00	782.854.00	799,854.00
	Numri i stafit	41	41	41	41

Informata mbi Udhëheqësinë:

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës,

Zyra e Kuvendit Komunal

Deklarata e vizionit:

Një Komunë shembull për Komunitet tjerë me mundësi zhvillimi me të drejta të barabarta për të gjithë gratë dhe burrat e Komunës dhe trajtimi i prioriteteve në të gjitha fushat e zhvillimit si Komunë.

Deklarata e misionit:

Krijimi i rregulloreve të reja në harmoni me ligjet e aplikueshme, zbatimi i të gjitha dispozitave ligjore dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me qeverisjen komunale, zhvillimin ekonomik, barazisë gjinore, ngritjen e transparencës, llogaridhënies, efikasitetit të shërbimeve dhe rritjen e mirëqenies së banorëve të Komunës së Gjakovës

Deklarata e Qëllimit:

Zhvillimin e përgjithshëm të Komunës së Gjakovës, hapja e vendeve të reja të punës, përmirësimi i klimës së biznesit përmes inovacionit dhe subvencionimit të ndërmarrësve të rinj, arritja e nivelit më të lartë të standardit të jetës së banorëve të Komunës sonë, ngritje e nivelit të përgjithshëm të arsimit, barazisë gjinore, përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, tejkalimi i problemeve për kushtet bazike të jetës dhe përmbushja e ndryshimit të qëndrueshëm të Komunës së Gjakovës sonë. Përveq kësaj synojmë ta përvetësojmë nivelin e performancës dhe lidhur me këtë të përfitojmë fonde shtesë nga donatorët.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 - 2029

	ASAMBLEJA KOMUNALE (DELEGATËT)	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	397,450.00	454,970.00	454,970.00	454,970.00
2.	Mallra dhe shërbime	30,000.00	30,000.00	30,000.00	30,000.00
	TOTALI	427,450.47	484,970.00	484,970.00	484,970.00
	Numri i stafit	39	39	39	39

Informata mbi Udhëheqësinë:

Shfaqet Shehu

Kryesues i Kuvendit të Gjakovës,

Drejtoria e Administratës dhe Personelit

Deklarata e Vizionit:

Vizioni i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është të rrisë efikasitetin e shërbimeve komunale, të shkurtojë kohën për kryerjen e shërbimeve, të digjitalizojë shërbimet administrative të ofrojë transparencë në këto shërbime, të rrisë shërbimet informative komunale, instalimin e shtyllave multifunksionale duke ofruar qetësi dhe siguri për qytetarët e Komunës së Gjakovës. Njëkohësisht ti përmbushë obligimet e Drejtorisë që ka sipas statutit të Komunës dhe ligjit në fuqi, si dhe në menaxhimin e stafit të shërbimit civil dhe duke siguruar përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në personel. Krijimi dhe mishërimi i një kodi të etikës profesionale në kulturën institucionale në terma afatgjatë.

Deklarata e misionit:

Misioni i Drejtorisë për Punë të Përgjithshme administrative është të zbatojë të gjitha procedurat administrative të cilat janë me ligj, statut dhe rregulloren e punës së kuvendit, të ofrojë qasje transparente dhe shërbime efikase në të gjitha shërbimet administrative; të ofrojë konsulentë për bashkëpunim për të gjitha drejtoritë tjera dhe Kryetarin e Komunës, sigurimin e këshillave në zhvillimin organizativ dhe për formulimin, autorizimin dhe zbatimin e menaxhimit dhe programet zhvillimore të stafit, ofrimin e një shërbimi digjital dhe të shpejtë për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjakovës, përgjegjësit dhe detyrat të cilat rrjedhin për qështjet e integritetit europian; Bashkëpunim me të gjitha Ministritë relevante për të ofruar qasje të drjetëpërdrejtë për të gjitha punët administrative, gjithashtu dhe punë të tjera që kanë të bëjnë me qështjet administrative që vijnë nga Kuvendi, Kryetari dhe Drejtoritë tjera.

Deklarata e Qëllimit:

Qëllimi i Drejtorisë është që të ofrojë një pasqyrë transparente, rritje të efikasitetit të shërbimeve komunale dhe të rrisë mirëqenjen dhe efikasitetin e shërbyesve civil pranë administratës komunale si dhe barazinë gjinore brenda administratës komunale. Përfitues të objektivave dhe vizionit të Drejtorisë janë qytetarët e Komunës së Gjakovës.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	314,303.00	312,303.00	312,303.00	312.303.00
2	Mallra dhe shërbime	520,000.00	600,000.00	600,000.00	600,000.00
3	Komunalitë	70,000.00	80,000.00	80,000.00	80,000.00
4	Shpenzimet kapitale				
	TOTALI	904,302.94	992,303.00	992,303.00	992,303.00
	Numri i stafit	31	31	31	31

Informata mbi Udhëheqësinë:

Zeqë Tahiraj

Drejtor i Drejtorisë së Administratës dhe Personelit,

Zyra e Prokurimit

Deklarata e vizionit:

Një Komunë shembull për Komunitet tjerë me mundësi zhvillimi me të drejta të barabarta për të gjithë gratë dhe burrat e Komunës dhe trajtimi i prioriteteve në të gjitha fushat e zhvillimit si Komunë.

Deklarata e misionit:

Krijimi i rregulloreve të reja në harmoni me ligjet e aplikueshme, zbatimi i të gjitha dispozitave ligjore dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me qeverisjen komunale, zhvillimin ekonomik, barazisë gjinore, ngritjen e transparencës, llogaridhënies, efikasitetit të shërbimeve dhe rritjen e mirëqenies së banorëve të Komunës së Gjakovës

Deklarata e Qëllimit:

Zhvillimin e përgjithshëm të Komunës së Gjakovës, hapja e vendeve të reja të punës, përmirësimi i klimës së biznesit përmes inovacionit dhe subvencionimit të ndërmarrësve të rinj, arritja e nivelit më të lartë të standardit të jetës së banorëve të Komunës sonë, ngritje e nivelit të përgjithshëm të arsimit, barazisë gjinore, përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, tejkalimi i problemeve për kushtet bazike të jetës dhe përmbushja e ndryshimit të qëndrueshëm të Komunës së Gjakovës sonë. Përveq kësaj synojmë ta përvetësojmë nivelin e performancës dhe lidhur me këtë të përfitojmë fonde shtesë nga donatorët.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	PROKURIMI	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	66,879.00	77,000.00	77,000.00	77,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00
	TOTALI	76,878.90	87,000.00	87,000.00	87,000.00
	Numri i stafit	7	7	7	7

Informata mbi Udhëheqësinë:

Faton Gutaj

Udhëheqës i Prokurimit,

Drejtoria e Inspeksionit

Deklarata e Vizionit:

Vizioni i Drejtorisë për Punë Inspektuese për periudhën e shënuar, është që të hartoj dhe amendamentoj Rregullore Komunale nga fushë veprimtaria e saj, si Rregullore të Inspektimit për Inspektorët nga Drejtoria për Punë Inspektuese, hartimin e disa dokumenteve tjera mbështetëse, menaxhuese të punës, përshkruese të punës dhe dokumenteve tjera punuese. Këto dokumente do të përfshijnë: Manualin e Punës së Inspektimit, Instruksionet e Inspektimit për secilën fushë të inspektimit, duke përfshirë karakteristikat e fushëveprimit (veterinarinë, bujqësinë, mjedisin, sanitarinë, tregun etj.); Përshkrimeve të Punës sa më të sakta me natyrën e punës, kompetencat e duhura, aftësitë specifike, detyrat, raportimet etj. Gjithashtu Drejtoria për Punë Inspektuese, ka për vizion dhe detyrë që të zbatoj të gjitha procedurat, udhëzimet dhe politikat për implementimin sa më të mirë të aktiviteteve të kësaj drejtorie, të cilat do të bëhen konform udhëzimeve strategjike të Kryetarit të Komunës, dhe njëkohësisht ti përmbushë obligimet e Drejtorisë që ka sipas statutit të Komunës dhe Ligjeve në fuqi, si dhe të menaxhoj Inspektorët, buxhetin dhe financat e kësaj drejtorie.

Deklarata e Misionit:

Misioni i Drejtorisë për Punë Inspektuese është inspektimi i subjekteve ekonomike si dhe ndërmarrja e masave komformë ligjeve në fuqi, me qëllim të parandalimit të dukurive negative: mbrojtjen e shëndetit publik, mbrojtjen e ambientit, mbrojtjen ndaj diskriminimit, mbikëqyrjen e zbatimit të Rregulloreve Komunale dhe ligjeve në fuqi, mbrojtjen e konsumatorit etj. Harmonizimi me ligjet në fuqi duke i definuar qartë përgjegjësitë komformë autorizimeve dhe obligimeve ligjore.

Deklarata e Qëllimit:

Qëllimi i Drejtorisë për Punë Inspektuese është të kontribuoj në arritjen e politikave strategjive dhe objektivave të urdhëresave përmes inspektimeve efektive dhe efikase në lëmitë përkatëse që i takojnë Drejtorisë për Punë Inspektuese. Të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve Komunale dhe të kontribuoj në rritjen e mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Gjakovës.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	DREJTORIA PËR INSPEKSION	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	277,597.00	280,869.00	280,869.00	280,869.00
2.	Mallra dhe shërbime	120,000.00	130,000.00	130,000.00	130,000.00
	TOTALI	397,596.82	410,869.00	410,869.00	410,869.00
	Numri i stafit	23	23	23	23

Informata mbi Udhëheqësinë:

Ervin Shabani

Drejtör i Inspeksionit,

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Deklarata e vizionit:

Planifikimin e buxhetit komunal sipas Qarkoreve Buxhetore, menaxhimin e financave komunale, këshillimi i zyrtarëve komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin dhe financat. Krijimit të një sistemi unik dhe transparent të pagesave dhe lidhur me këtë rritja e të hyrave vetanake.

Deklarata e misionit:

Bënë menaxhimin e buxhetit dhe financave të Komunës, i siguron informatat për drejtoritë – programet komunale, menaxhimin e shpenzimeve, llogarive të arkëtueshme dhe informimin e udhëheqësve komunal lidhur me gjendjen dhe aktualitetet e ndërlidhura me buxhetin komunal dhe siguron implementimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.

Deklarata e Qëllimit:

Menaxhimi me efikasitet të buxhetit komunal, përgatitja e buxhetit komunal për të gjitha programet buxhetore brenda afateve kohore të përcaktuara nga MF, rishikimet buxhetore, rialokimet, transferet, bartja e të hyrave vetanake, ngritja e barazisë gjinore përmes alokimeve buxhetore, regjistrimi i pasurive financiare dhe jo financiare në pronësi komunale, analizat, raportet financiare etj.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve : 2027- 2029

	DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	287,605.00	299,500.00	299,500.00	299,500.00
2.	Mallra dhe shërbime	50,682.00	50,682.00	50,682.00	50,682.00
3.	Shpenzimet kapitale	153,842.00	1,297,166.00	3,273,126.00	7,089,279.00
	TOTALI	492,128.92	1,647,348.00	3,623,308.00	7,439,461.00
	Numri i stafit	28	28	28	28

Informata mbi Udhëheqësinë:

Durim Halilaj

Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,

Drejtoria e Shërbimeve Publike – Infrastruktura Rrugore

Deklarata e vizionit:

Drejtoria e Infrastrukturës do të jetë një lider në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore si dhe planifikimin dhe mbikëqyrjen e trafikut dhe transportit.

Deklarata e misionit:

Misioni i Drejtorisë për Infrastrukturë është për të ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë efektive infrastrukturën dhe objektet publike, dhe ofron shërbime për publikun për të arritur nevojat e përbashkëta sociale, ekonomike dhe mjedisore. Drejtoria për Infrastrukturë merr një qasje pro-aktive drejt zhvillimit të infrastrukturës rrugore, trafikut dhe transportit rrugor.

Deklarata e Qëllimit:

Qëllimet tona janë që të arrijmë objektivat e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore sipas standardeve bashkohore, duke përmirësuar nivelin e shërbimit në transport, duke rritur sigurinë në trafikun rrugor si dhe duke qenë miqsor me ambientin dhe mjedisin.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve : 2027- 2029

	DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE – INFRASTRUKTURA RRUGORE	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	73,836.00	85,000.00	85,000.00	85,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	150,000.00	200,000.00	200,000.00	200,000.00
3.	Shpenzimet kapitale	9,415,116.00	7,100,000.00	3,850,000.00	2,600,000.00
	TOTALI	9,638,951.93	7,385,000.00	4,135,000.00	2,885,000.00
	Numri i stafit	7	7	7	7

Informata mbi Udhëheqësinë:

Shkumbin Kastrati

Drejtor i Drejtorisë për Infrastrukturë

Drejtoria e Shërbimeve Publike - INFRASTRUKTURA PUBLIKE

Deklarata e vizionit:

Drejtoria e Shërbimeve Publike do të jetë e njohur për ofrimin e shërbimeve publike sa i përket profesionalizmit. Vizion ynë i qartë është përmbyllja e infrastrukturës rrugore në tërë territorin e Komunës.

Deklarata e misionit:

Misioni i Drejtorisë për Shërbime Publike është për të ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë efektive infrastrukturën dhe objektet publike dhe ofron shërbime për publikun për të arritur dëshirat e përbashkëta sociale, ekonomike dhe mjedisore. Drejtoria për Shërbime Publike merr një qasje proaktive drejtë qëndrueshmërisë duke shëndrruar metodat e transportit, konsumit të energjisë, menaxhim me mbeturina, planifikimin urban dhe arkitekturë të qëndrueshme për të ruajtur dhe për të përmirësuar qytetin për brezat e ardhshëm.

Deklarata e Qëllimit:

Për të mirëmbajtur, mbrojtur dhe për të ruajtur në kuadër të autoritetit të parashikuara në Ligjet e Kosovës si dhe Rregulloreve të Komunës , strukturat fizike dhe objektet të cilat janë përcaktuar të nevojshme për qëllime publike dhe për të ofruar shërbime për publikun për të lehtësuar arritjen e përbashkët sociale, ekonomike, dhe dëshirat mjedisore.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve : 2027- 2029

	DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE – INFRASTRUKTURA PUBLIKE	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	74,192.00	79,000.00	79,000.00	79,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	1,100,000.00	1,200,000.00	1,300,000.00	1,300,000.00
3.	Shpenzimet Komunale	290,000.00	390,000.00	430,000.00	500,000.00
4.	Subvencionet	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00
5.	Shpenzimet kapitale	700,000.00	950,000.00	1,250,000.00	950,000.00
	TOTALI	2,174,191.80	2,629,000.00	3,069,000.00	2,839,000.00
	Numri i stafit	8	8	8	8

Informata mbi Udhëheqësinë:

Jon Bytyqi

Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim + Zjarrfikëset

Deklarata e Vizionit:

Vizioni i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim është përmirësimi i ambientit dhe krijimi i kushteve për funksionimin e institucioneve publike dhe private, për një jetë të qetë dhe të sigurt të qytetarëve, Ofrimi i sigurisë njerëzore, të kafshëve dhe bimëve, ofrimi i mjeteve në përkrahje të dëmtuarve dhe përmirësimi i kualitetit të jetesës etj.

Deklarata e Misionit:

Ky mision ka për qëllim krijimin e bazës metodologjike dhe profesionale për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve konkrete në parandalimin, zvogëlimin dhe sanimin e dëmeve të shkaktuara nga katastrofat dhe fatkeqësitë tjera të mëdha natyrore të cilat me efekt të menjëhershëm do të shkaktonin dëme në popullatën civile, pronën e tyre, në mjedisin, trashëgiminë kulturore etj.

Deklarata e Qëllimit:

Bënë koordinimin sa më efikas të drejtorisë me subjekte relevante të gjitha niveleve të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe në mënyrë profesionale në rastet e fatkeqësive natyrore dhe katastrofave tjera të mundshme, si dhe koordinimi i ekipeve emergjente me subjektet përkatëse në menaxhimin e situatave emergjente. Parandalimi dhe zvogëlimi i pasojave të mundshme nga fatkeqësitë e ndryshme në kohë dhe hapësirë.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM + ZJARRËFIKËSAT	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	483,927.00	761,476.00	761,476.00	761,476.00
2.	Mallra dhe shërbime	100,000.00	100,000.00	110,000.00	110,000.00
3.	Komunalitë	20,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00
4.	Shpenzime kapitale		250,000.00	300,000.00	250,000.00
	TOTALI	603,927.00	1,131,476.00	1,191,476.00	1,141,476.00
	Numri i stafit	55	55	55	55

Informata mbi Udhëheqësinë:

Haxhi Sejdiu

Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim,

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Deklarata e vizionit:

ZKKK mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve, krijon qasje të barabartë për të gjithë gratë dhe burrat nga komunitetet në shërbimet publike, ngrit arsimimin tek komunitetet. Po ashtu, ZKKK bënë përpjekje në krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar.

Deklarata e misionit:

Menaxhon dhe koordinon stafin e ZKKK-së si dhe punët dhe aktivitetet e saj me nivelin lokal, përkatësisht me Drejtoritë Komunale si dhe me nivelin qendror me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete në projektin e kthimit të qëndrueshëm të burrave dhe grave të zhvendosur dhe të refugjatëve si dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme për ri-integrimin e personave të riatdhesuar.

Deklarata e Qëllimit:

Qëllimi kryesor i ZKKK-së është promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre; zhvillimi dhe integrimi i të gjithë komuniteteve në Komunën e Gjakovës, krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm të personave të zhvendosur, refugjatëve dhe të riatdhesuarve.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	41,430.00	37,000.00	37,000.00	37,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	25,000.00	27,000.00	27,000.00	27,000.00
4.	Subvencione	35,000.00	40,000.00	40,000.00	40,000.00
	TOTALI	101,430.00	104,000.00	104,000.00	104,000.00
	Numri i stafit	4	4	4	4

Informata mbi Udhëheqësinë:

Armend Behluli

Udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthime,

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural

Deklarata e vizionit:

Gjakova qendër e prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore cilësore për Kosovën dhe rajonin.

Deklarata e misionit:

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë i harmonizuar sipas standardeve dhe praktikave të BE-së duke respektuar Politikën e Zhvillimit Rural (PZHR) të BE-së, normat ekologjike dhe konkurruese me vendet e rajonit dhe i mbështetur nga fondet zhvillimore lokale, qeveritare dhe ndërkombëtare.

Deklarata e Qëllimit:

Objektivat gjenerale të zhvillimit të bujqësisë së Komunës së Gjakovës janë në harmoni me objektivat dhe strategjinë zhvillimore 2014 – 2020 të Republikës së Kosovës dhe në koherencë me prioritetet e zhvillimit rural të rajonit dhe të BE-së:

Edukimi i vazhdueshëm / Përcjellja e inovacioneve në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural;

Forcimi i zingjirit ushqimor, mbrojtja e kafshëve dhe menaxhimi i rrezikut në bujqësi;

Përfshirja sociale, barazia gjinore, zvogëlimi i varfërisë dhe zhvillimi ekonomik në viset rurale;

Mbështetja institucionale në riaktivizimin e fermave, plantacioneve bujqësore dhe kapaciteteve përpunuese ushqimore në Komunën e Gjakovës;

Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe rritje të sipërfaqeve punuese me sistem të ujitjes në funksion të rritjes së rendimentit;

Kultivimi i frutave të malit përmes ofrimit të qasjes në rrugët malore, me rregullimin e tyre.

Mbështetja e zhvillimit ekonomik të Komunës – subvencionimi me qëllim të nxitjes së investimeve në fushat:

- ❖ Pemëtari;
- ❖ Perimtari;
- ❖ Lavërtari;
- ❖ Blegtori;
- ❖ Vreshtari;
- ❖ Bletari, dhe
- ❖ Produktet e veçanta (kërpudha, bimë medicinale dhe aromatike, kërmijtë, etj.).

Tabela1. Performancë: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	71,868.00	78,000.00	78,000.00	78,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	20,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00
3.	Komunalitë	2,000.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00
4.	Subvencione	170,000.00	190,000.00	200,000.00	250,000.00
5.	Shpenzimet kapitale	450,000.00	450,000.00	550,000.00	600,000.00
	TOTALI	713,868.00	740,000.00	850,000.00	950,000.00
	Numri i stafit	6	6	6	6

Informata mbi Udhëheqësinë:

Gani Hajdari

Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Deklarata e vizionit:

Komunë e zhvilluar ekonomikisht me shërbime cilësore dhe efikase për komunitetin, e integruar mirë në zhvillimin rajonal dhe ndërkombëtar.

Deklarata e misionit :

Krijimi i ambientit të përshtatshëm për zhvillim e ndërmarrjeve në sektorët më potencial zhvillimor, me theks të posaçëm në sektorët e prodhimit dhe përpunimit, turizmit, përfshirë artizanalet që promovojnë vlera të trashëgimisë kulturore, duke ofruar infrastrukturë të përshtatshme ligjore , ekonomike dhe sociale për gratë dhe burrat ndërmarrës.

Deklarata e Qëllimit:

Promovimi i zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante sektoriale, bizneset, OJQ-të, shoqërinë civile, donatorët dhe investitorët potencial.

Objektivi i Përgjithshëm:

Të Zhvillohet dhe avancohet sektori i NMV-ve dhe turizmit në Gjakovë.

Objektivat Specifike: (OS)

1. Krijimi i kushteve për rritjen e numrit dhe të zgjerimit të kapaciteteve të NMV-ve prodhuese;
2. Zhvillimi dhe promovimi i turizmit;
3. Sigurimi i klimës së favorshme për tërheqjen e investimeve të huaja dhe të diasporës;
4. Promovimi dhe rritja e bashkëpunimit ndërkufitar në fushën e biznesit dhe turizmit;
5. Zhvillimi dhe funksionalizimi i Gjakovës si Zonë e Lirë ekonomike;

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	118,768.00	123,000.00	123,000.00	123,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	50,000.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00
3.	Subvencionet	150,000.00	160,000.00	180,000.00	200,000.00
5.	Shpenzimet kapitale	370,000.00	200,000.00	400,000.00	400,000.00
	TOTALI	688,768.00	533,000.00	753,000.00	773,000.00
	Numri i stafit	12	12	12	12

Informata mbi Udhëheqësinë:

Ferdinand Kolaj

Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik,

Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi

Deklarata e Vizionit:

Proteksionizmi i punës së shërbimit kadastral, aplikimi i teknologjisë bashkëkohore komforë Ligjit mbi Kadastrën.

Deklarata e misionit:

Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të aplikueshme dhe zgjidhja e tyre komforë dokumentacionit tekniko-gjeodezik, pronësor dhe ligjeve në fuqi.

Mision tjetër i drejtorisë është rievimi i lagjeve dhe regjistrimi i pronave të pa luajtshme në tërë territorin e Komunës.

Deklarata e Qëllimit:

Përmes aplikimit të teknologjisë së përparuar të rritet efikasiteti dhe kualiteti i shërbimeve kadastrave, komforë saj edhe inkasimi i të hyrave nga kjo veprimtari si dhe shqyrtimi dhe zgjidhja e raporteve pasurore-juridike, komforë ligjeve në fuqi.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	SHËRBIMET KADASTRALE	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	181,578.00	203,000.00	203,000.00	203,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	20,000.00	20,000.00	23,000.00	23,000.00
3.	Komunalitë	10,000.00	15,000.00	15,000.00	15,000.00
4.	Shpenzimet kapitale	1,200,000.00	500,000.00	600,000.00	700,000.00
	TOTALI	1,411,578.00	738,000.00	841,000.00	941,000.00
	Numri i stafit	19	19	19	19

Informata mbi Udhëheqësinë:

Lediana Bardhi

Drejtore i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Deklarata e vizionit:

Urbanizim gjithëpërfshirës për tërë territorin e Komunës si bazament për zhvillim të hovshëm të planifikuar në bazë të kornizës zyrtare ligjore përmes Planit Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale Komunale dhe Planeve Rregullative të Hollësishme. Fuqizimi i shtrirjes dhe mbulimit të Komunës me Plane Urbanistike komforë legjislacionit aktual.

Deklarata e misionit:

Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të aplikuarve dhe zgjidhja e tyre komforë dokumentacionit tekniko-urbanistik dhe ligjeve në fuqi. Trajtimi dhe legalizimi i objekteve pa leje ndërtimi. Rekognisimi dhe krijimi i bazës me të dhëna për gjendjen urbane dhe biologjike të mjedisit. Përmbyllja e planifikimit hapësinor me dokumentacionet bazike si Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale Komunale.

Deklarata e Qëllimit:

Përmes Kompletimit të platformës me dokumente hapësinore si Harta Zonale Komunale dhe Planet Rregulluese të mundësojmë zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës, respektivisht të rrisim cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve, cilësinë e mjedisit dhe të hyrat

buxhetore komunale. Të krijojmë platformë të saktë mbi gjendjen e mjedisit për inicimin dhe implementimin e proceseve për sanim dhe rehabilitim të mjedisit si dhe aplikim të qasjeve inovative në fushën e planifikimit hapësinor.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	181,762.00	190,000.00	190,000.00	190,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	100,000.00	100,000.00	110,000.00	110,000.00
3.	Shpenzimet kapitale		100,000.00	100,000.00	
	TOTALI	281,762.00	390,000.00	400,000.00	300,000.00
	Numri i stafit	18	18	18	18

Informata mbi Udhëheqësinë:

Gjevalin Nikollbibaj

Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm,

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Deklarata Vizionit:

Shëndet të mirë dhe mirëqenie sociale dhe barazi gjinore për popullatën e Komunës.

Deklarata e Misionit:

DSHMS bashkë rendit dhe mbikëqyr K.P.Sh. dhe QPS për :

- ❖ ofrimin e shërbimeve (specifike) në sasi, cilësi dhe llojshmëri për popullatën;
- ❖ avancimin e kushteve të punës së të punësuarve në këto sektorë;
- ❖ duke u bazuar në respektimin e normave ligjore;
- ❖ identifikon nevojat / kërkesat e qytetarëve dhe
- ❖ orienton shërbimet në KPSH dhe QPS në përmbushjen e kërkesave për ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenies sociale, siguron ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje.

Deklarata e Qëllimit:

Plotësimi i nevojave dhe kërkesave të banorëve të Komunës për mirëqenie shëndetësore dhe sociale dhe barazi gjinore.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	4,181,479.00	4,308,467.00	4,408,467.00	4,658,467.00
2.	Mallra dhe shërbime	760,000.00	833,000.00	860,000.00	960,000.00
3.	Komunalitë	100,000.00	110,400.00	130,000.00	130,000.00
4.	Subvencione	150,000.00	150,000.00	190,000.00	263,000.00
5.	Shpenzimet kapitale	38,985.00			
	TOTALI	5,230,464.00	5,401.867.00	5,588,467.00	6,011,467.00
	Numri i stafit	361	361	361	361

Shërbimet Sociale

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	DREJTORIA PËR SHERBIMET SOCIALE	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	185,785.00	197,568.00	197,568.00	197,568.00
2.	Mallra dhe shërbime	30,000.00	30,000.00	30,000.00	30,000.00
3.	Komunalitë	8,000.00	8,000.00	8,000.00	8,000.00
4.	Subvencionet	20,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00
5.	Shpenzimet kapitale				
	TOTALI	243,785.00	255,568.00	255,568.00	255,568.00
	Numri i stafit	18	18	18	18

Shërbimet Rezidenciale

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	DREJTORIA PËR SHERBIMET REZIDENCIALE	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	50,000.00	55,503.00	55,503.00	55,503.00
2.	Mallra dhe shërbime	45,000.00	45,000.00	45,000.00	45,000.00
3.	Shpenzime Komunale	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00
4.	Shpenzimet kapitale	610,000.00	514,279.00	610,000.00	610,000.00
	TOTALI	710,000.00	619,782.00	715,503.00	715,503.00
	Numri i stafit	5	5	0	0

Informata mbi Udhëheqësinë

Lulzim Goqi

Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale,

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Deklarata e Vizionit:

Arritje e një kulture të avancuar dhe moderne, rini të shëndoshë, prosperuese në të gjitha lëmit, gjithëpërfshirëse dhe rezultate.

Deklarata e Misionit:

Përkushtimi permanent ndaj avancimit në lëmin e kulturës, rinisë dhe sporteve, ruajtjen e trashëgimisë dhe vlerave kulturore, teatrale, sipas kërkesave bashkëkohore që kanë të bëjnë me plotësimin e nevojave të komunitetit.

Deklarata e Qëllimit:

Arritja e standardeve sa më të larta në sferën e kulturës, rinisë dhe sporteve, vetëdijësim i përgjithshëm për ruajtje dhe prezantim të vlerave tradicionale.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	565,193.00	614,655.00	614,655.00	614,655.00
2.	Mallra dhe shërbime	162,000.00	162,000.00	162,000.00	162,000.00
3.	Komunalitë	90,000.00	90,000.00	90,000.00	90,000.00
4.	Subvencione	277,000.00	290,053.00	280,053.00	280,053.00
5.	Shpenzimet kapitale	430,000.00	850,000.00	520,000.00	
	TOTALI	1,524,193.00	2,006,708.00	1,666,708.00	1,146,708.00
	Numri i stafit	56	56	56	56

Informata mbi Udhëheqësinë:

Adea Roka

Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte,

Drejtoria për Arsim dhe Shkencë

Deklarata e vizionit:

Të sigurojë barazinë e mundësisë për të ndjekur arsimi cilësor për të gjithë nxënësit parashkollor, fillor dhe të mesëm të gjithë qytetarëve të Komunës përfshirë edhe pakicat / minoritetet, të mbështesë zhvillimin dhe aftësimin e personelit, të nxisë bashkëpunimin midis mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore.

DKA orienton të gjithë nën sektorët në aktivitete të tyre të rregullta afatmesme, në planifikimin vjetor, të përkrahim, të bashkërendisim, të rregullojmë dhe të promovoj arsimin cilësor për të gjithë qytetarët.

DKA do të sigurojë një bazë për bashkërenditjen dhe negocimin me agjensitë qeveritare me partnerët zhvillimor dhe me palët tjera kryesore në sektorin e arsimit.

Deklarata e misionit:

Drejtoria për Arsim ushtron funksionet dhe përgjegjësit e saj në bazë të ligjit për arsimin para universitar. Kjo drejtori krijon mundësinë për zhvillimin dhe përkrahjen e një sistemi gjithëpërfshirës arsimor ku siguron qasje të barabarte të gjithë djemve dhe vajzave nga prapavija të ndryshme për arsimin e tyre në institucionin parashkollor, arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës. Gjithashtu krijon kushte dhe u jep mundësi të gjithë mësimdhënësve në aftësimin profesional përmirësimin e relevances, rritjen e kualifikimit. DKA kërkon forcimin e mekanizmave të llogaridhënies përmes vlerësimit të performancës. Zbatimi i kurrikules nëpër shkollë, zbatimi i politikave të reja në arsim duke siguruar asistencë tek fëmijet me nevojë të veçanta, zhvillimi i praktikës profesionale, koordinatorët e cilësisë si dhe zbatimi i kontratës kolektive.

Deklarata e Qëllimit:

Arritja e standardeve të larta në sferën e arsimit, përfshirja e të gjithë djemve dhe vajzave nga prapavijat e ndryshme në shkollë ku qëllimet janë në harmoni me objektivat dhe Strategjinë zhvillimore ku përfshihen integritet dhe institucioneve arsimore, zbatimin e programeve të veçanta për parandalimin e braktisjes së shkollës, identifikimi i fëmijëve me nevojë të veçanta si dhe transporti i nxënësve në shkollë.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	DREJTORIA PËR ARSIM DHE SHKENCË	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	13,785,430.00	14,882,835.00	14,982,835.00	15,232,835.00
2.	Mallra dhe shërbime	927,318.00	952,318.00	1,002,318.00	1,102,318.00
3.	Komunalitë	415,000.00	420,000.00	420,000.00	450,000.00
4.	Subvencione	570,000.00	570,000.00	600,000.00	636,947.00
5.	Shpenzimet kapitale	236,000.00	564,000.00	1,350,000.00	960,000.00
	TOTALI	15,933,748.00	17,389,153.00	18,335,153.00	18,382,100.00
	Numri i stafit	1567	1567	1567	1567

Informata mbi Udhëheqësinë:

Hysen Brahimaj

Drejtor i Drejtorisë së Arsimit,

PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP)

Vlerësimi i Kapaciteteve Investuese

Është hulumtim i potencialit dhe burimeve të mundshme për financim të zbatimit të Planeve Zhvillimore, si dhe drejtimit të Investimeve Kapitale Publike.

Komunat në Republikën e Kosovës, kanë rol qendror në caktimin e prioriteteve të investimeve kapitale dhe në aranzhimin e investimeve lokale përmes mekanizmave të cilat i kanë në dispozicion. Kjo mund të përfshijë gjenerimin e të hyrave lokale, vjeljen e taksave dhe tarifave, zhvillimin e partneriteteve publike-private, aranzhimin e ndarjes së drejtë të projekteve kapitale dhe borxheve.

Komunat po bëhen gjithnjë e më të vetëdijshme se investitorët ndërkombëtarë dhe të brendshëm, huadhënësit dhe agjencitë kreditore i konsiderojnë qeveritë lokale si klientë të mirë për biznes, me kusht që ato ti ndjekin praktikën e mira të afarizmit.

Kryetari i Komunës së bashku me Kuvendin Komunal si organ legjislativ dhe Komiteti për Politikë dhe Financa janë përgjegjëse për përgatitjen e buxhetit, i cili përfshinë programin e investimeve kapitale dhe buxhetin.

Draft Propozimi i Programit Komunal për Investime Publike në masë të duhur ka marrë parasysh kërkesat – propozimet fillestare të Drejtorive komunale (Programeve buxhetore) – Projektet e propozuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitet 2027 / 2029 sipas proceseve buxhetore të zhvilluara gjatë këtij viti.

Sipas vlerësimeve të shpenzimeve totale buxhetore - investimet kapitale për vitin 2027 të mbetura pas zbritjes së shpenzimeve të pagave, mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale dhe subvencioneve të paraqitura, atëherë për investime kapitale për vitin 2027 mbetet shuma prej **12,775,445.00 €** nga buxheti total i Komunës për vitin 2027.

Ndërsa për vitin 2028 mbetet shuma 12,803,126.00 € për shpenzimet kapitale dhe për vitin 2029 shuma prej 14,159,279.00€, derisa Kërkesat e Drejtorive janë shumë më të mëdha se sa që ofrojnë limitet buxhetore sipas Qarkores së parë Buxhetore nr. 2027/01, të MFPT-së për Komunën e Gjakovës për periudhën: 2027-2029, siç shihet edhe në Tabelën e Investimeve kapitale, e cila i bashkëngjitet këtij KAB-i.

Gjakovë,
Qershor 2026

Drejtoria për Buxhet dhe Financa